



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 89.
Prishtinë, më 5.03.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, , Saša Milosavljević, Jelena Bontic, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Hatim Baxhaku, Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Elita Vokshi dhe Lejla Selimi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 5. Te Ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 04/L-250 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës me

Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 Prokurimin Publik në Republikës e Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Elmi Reçica– i njoftoi anëtarët e komisionit, se sot grupi punues ka mbajtur takim lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, dhe se është në përfundim të nxjerrjes së rekomandimeve. Ai konstatoi se raporti do të shqyrtohet në komision javën e ardhshme dhe i njëjti do të përcillet në Kryesin e Kuvendit që të procedohet për Seancë Plenare.

Ai ngriti edhe një çështje të rëndësishme, se grupi punues është në fazën përfundimtare të monitorimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizreni dhe Ligjit për Hoçë të Madhe dhe propozimi i tij ishte që të realizohen vizitat e mbetura në teren dhe më pas të dilet me raport final në komision.

Kryesuesja - u pajtua se në kuadër të monitorimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizreni dhe Ligjin për Hoçë të Madhe, grupi punues ka dërguar pyetje në institucionet relevante dhe janë marrë përgjigjet me shkrim, janë mbajtur dy dëgjime publike, vizitat e realizuara në terren.

Pasi janë ndërruar strukturat komunale, ajo propozoi që të vizitohet edhe një herë komuna e Prizrenit për të vëzhguar funksionalizimin e Këshillit për Trashëgimin Kulturore nga ana e Kuvendit Komunal, sipas ligjit në fuqi dhe sa ka vullnet të mirë kuvendi komunal i Rahovecit në themelimin e këshillit të Hoçës të Madhe. Pas kësaj faze, grupi punues do të përgatisë draft- raportin e mbikëqyrjes të këtyre dy ligjeve dhe në një afat të shkurtër kohor do të dalë me raport final për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković